



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislacioni IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Punë të Jashtme

Mbledhja nr. 68

Prishtinë, më 18 dhjetor 2013, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-1

P r o c e s v e r b a l

I mbledhjes së Komisionit për Punë të Jashtme

Në mbledhje morën pjesë: Albin Kurti, Hydajet Hyseni, Enis Kervan, Sabri Hamiti, Skender Hyseni, Donika Kadaj-Bujupi, Emilija Rexhepi dhe Hamza Balje.

Mungoi: Berat Buzhala.

Pjesëmarrës të tjetër: Dren Doli- GLPS dhe Fidan Rama – gazeta “Tribuna”.

Nga Zyra e Komisionit: Minire Hasani, Manush Krasniqi dhe Gurjeta Zeka - praktikante.

Mbledhjen e kryesoi, Albin Kurti, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

R e n d d i t e:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 11 e 20 nëntor dhe 5 dhjetor 2013;
3. Informatë nga Raporti i Progresit 2013 të Komisionit Evropian – Vlerësimi i politikës së jashtme të Kosovës;
4. Shqyrtimi i Raportit për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Marrëveshjet Ndërkombëtare;
5. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari konstatoi se Komisioni e miratoi rendin e ditës.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 11 e 20 nëntor dhe 5 dhjetor 2013

Kryetari konstatoi se Komisioni i miratoi njëzëri procesverbalet nga mbledhjet e mbajtura më 11 e 20 nëntor dhe 5 dhjetor 2013.

3. Informatë nga Raporti i Progresit 2013 të Komisionit Evropian – Vlerësimi i politikës së jashtme të Kosovës

Albin Kurti – Lidhur me Raportin e Progresit të Komisionit Evropian, për Kosovën, për vitin 2013, tha se në mbledhjen e kaluar të Komisionit është kërkuar që të bëhet një vlerësim i politikës së jashtme të Kosovës, dhe obligimeve që dalin për Komisionin për Punë të Jashtme, nga ky raport. Në këtë drejtim njoftoi se në emër të Komisionit ka parashtruar një kërkesë, për Drejtorinë për hulumtime në Kuvend, që të punohet një hulumtim në mënyrë që Komisioni të njoftohet më hollësisht dhe në mënyrë profesionale lidhur me gjendjen e politikës së jashtme të Kosovës sipas Raportit të Komisionit Evropian për vitin 2013 dhe obligimet që dalin nga ai për Komisionin. Lidhur me punimin i cili ju është shpërndarë anëtarëve të Komisionit, ai tha se planifikon të takohet me Drejtorinë për Hulumtime në Kuvend, pasi që hulumtimi i bërë nga ata, është tepër teknik nuk përmban elemente hulumtimi, e as studim, por është një përmbledhje teknike e përmbajtjes së Raportit të Progresit, nga këndvështrimi i politikës së jashtme.

Sabri Hamiti – Lidhur me punimin që është bërë nga Drejtoria për Hulumtime në Kuvend tha se është evidentim i veprimtarisë së politikës së jashtme të Kosovës nga Raporti i Progresit. Duke pasur parasysh se Raporti i Progresit për Kosovës, do të jetë objekt diskutimi në seancën e nesërme, theksoi se është e nevojshme që të përcaktohen se, a do të ketë Komisioni një qëndrim lidhur me këtë pikë.

Albin Kurti – Tha se do të kishte qenë mirë ta kishin një qëndrim si Komision, lidhur me Raportin e Progresit. Sa i përket Raportit të Progresit, tha se lavdërohem shumë për dialog, se ligjet janë të mira në letër, dhe se ka një lloj heshtje të denoncimit të korrupsionit, të krimit të organizuar dhe të mungesës së transparencës. Theksoi se nesër në seancë plenare do të mund ta diskutonin çështjen e integriteteve evropiane nga pikëpamja e politikës së jashtme të një vendi të pavarur dhe sovran, e jo vetëm në mënyrë totalisht afirmative dhe jo kritike. Edhe nëse Komisioni nuk do të ketë qëndrim të përbashkët lidhur me Raportin e Progresit gjatë seancës së nesërme, tha se do të ishte mirë që secili anëtarë i Komisionit të diskutoj meqë kjo çështje është e lidhur ngushtë me fushëveprimtarinë e Komisionit për Punë të Jashtme.

Skender Hyseni – Duke u ndërlidhur me integritet evropiane në relacion me politikën e jashtme të Kosovës dhe MPJ-në si atribut i shtetësisë, në korrelacion me Rezolutën 1244 dhe neutralitetin ndaj statusit theksoi se është shqetësuese kur e dëgjon ministrin e Jashtëm duke thënë që Rezoluta 1244 ka vdekur. Ai tha se duhet të theksohet fuqishëm se është koha për alarm nëse ministri i Jashtëm i Republikës së Kosovës thotë me lehtësi që nuk ekziston Rezoluta 1244, përderisa vetë e kanë futur Kosovën në fusnotë. Sa i përket hulumtimit nga Drejtoria për Hulumtime lidhur me Raportin e Progresit, përkatësisht, vlerësimi të politikës së jashtme të Kosovës, tha se ai nuk është hulumtim dhe se politika e jashtme e Kosovës duhet të analizohet nga këndi se a ka politikë të jashtme të Kosovës në Bruksel dhe të trajtohet nga këndvështrimi ndaj statusit të Kosovës. Gjithashtu shtroi çështjen se çfarë është duke bërë ekzekutivi i Kosovës në Bruksel.

Hydajet Hyseni – Lidhur me Raportin e Progresit theksoi se do të mund të nxirret një qëndrim i përbashkët i Komisionit ku do të paraqiteshin pikat e përbashkëta, pa e privuar të drejtën që anëtarët e Komisioni të paraqesin specifikat e veta, gjatë diskutimit në seancë plenare. Duke vënë në pah se një qëndrim i përbashkët është vonë të përgatitet për seancën e nesërme, shprehu gatishmëri që të punohet në këtë drejtim me ndihmën edhe të partnerëve, të cilët e mbështesin punën e Komisionit. Ai propozoi të përgatitet një formë e dokumentit mbi analizën e Raportit të Progresit, i cili do të

përfshinte shumë çështje për diskutim dhe do të adresonte shumë çështje mbi bazën e të cilave do të mund të ndërmerreshin nisma për ndërtimin e një strategjie të integritetit të Kosovës në struktura të caktuara evropiane e ndërkombëtare.

Hamza Balje –Tha se e përkrah Raportin e Progresit me gjithë komentet për komunitetin shumicë dhe për komunitetet pakicë. Ai theksoi se duhet të kemi mirëkuptim, të punojmë dhe se komunitet kanë merita që disi ndryshe, të trajtohen. Hulumtimin lidhur me Raportin e Progresit tha se duhet ta shqyrtojë, dhe nëse është kopje nga Raporti i Progresit atëherë punimi është realitet i nxjerr nga Raporti i Progresit.

Albin Kurti – I falënderoj anëtarët për kontributin e dhënë, i inkurajoi ata që si anëtarë të Komisionit për Punë të Jashtme të marrin pjesë në diskutimin në seancë plenare për këtë çështje.

4. Shqyrtimi i Raportit për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Marrëveshjet Ndërkombëtare

Albin Kurti – I njoftoi të pranishmit se u është shpërndarë një raport me rekomandime nga grupi i punës lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Marrëveshjet Ndërkombëtare, i cili pas miratimit në Komision mund të përcillet për shqyrtim e miratim në seancë plenare.

Hydajet Hyseni – Tha se nuk është i kënaqur me punën e bërë pasi nuk është shteruar i gjithë informacioni i duhur, për shkak të mungesave nga institucionet e kontaktuara, pastaj ko incidimit me pushimet dhe me fushatën zgjedhore, të cilat e kanë vështirësuar punën e grupit punues. Lidhur me Raportin shprehu mendimin se është mirë të rishikohen tri çështje.

E para, tha se shumë anomali në fushën e marrëveshjeve ndërkombëtare derivohen nga statusi i Kosovës, Kushtetuta dhe Ligji për Marrëveshjet Ndërkombëtare nuk e sqarojnë dallimin në mes të marrëveshjeve dhe traktateve. Çështja e dytë ka të bëjë me ratifikimin, ligji nuk e sqaron sa duhet se, kush çka ratifikon. Kompetencën e ratifikimit të marrëveshjeve ndërkombëtare, Kushtetuta ia përshkruan vetëm Kuvendit, por në disa raste, përpos marrëveshjeve në paragrafin e parë, marrëveshjet ratifikohen pas nënshkrimit të Presidentit. Si problematike e konsideron faktin që duhet të kërkohet të fshihet një paragraf, ku thuhet se kjo dispozitë nuk vlen për marrëveshjet e nënshkruara nga Presidentja. Thuhet në ligj se Presidentja mund të arrij të bëjë marrëveshje dhe ato të nënshkruhen me rastin e arritjes së marrëveshjes, por nuk është sqaruar pastaj çështja e ratifikimit të këtyre marrëveshjeve. Çështje tjetër që duhet rishikuar tha se është roli i Ministrisë së Punëve të Jashtme. Analiza e Grupit për Studime dhe Juridike Politike thotë se roli i MPJ-së është i ekzagjeruar, por shprehu mendimin se roli i Ministrisë në këtë fushë është i domosdoshëm dhe se duhet marrë në konsideratë. Çështja e tretë që duhet rishikuar dhe e cila nuk është përpunuar sa duhet është çështja e marrëveshjeve Prishtinë-Beograd, se si trajtohen këto marrëveshje. Me tej shtoj se edhe pse janë vonuar në hartimin e raportit, Komisioni ka një bazë solide, të cilën mund ta plotësojë dhe ta ndryshojë. Kërkoi kohë shtesë për plotësimin e Raportit me rekomandime.

Sabri Hamiti – Propozoj që “konstatimet” në fund të Raportit të quhen “rekomandime”. Tha se prej 16 rekomandimeve, 5 janë me peshë, ato janë rekomandimet 3, 12, 13, 14 dhe 15, propozoj që ky grupim i rekomandimeve të jenë në fillim të raportit, pastaj të vijojnë tjerat si argumentime të kërkimit.

Donika Kadaj-Bujupi – Konsideron se ka mungesë të specifikimit duke shtuar se është dhënë vetëm një rekomandim për Qeverinë, ndërsa te pjesa e arsyetimeve qëndrojnë rekomandimet shtesë.

Përkrahu propozimin e deputetit S. Hamiti që pikat e cekura nga ai të vendosën në fillim të rekomandimeve, eventualisht të shtohet ndonjë tjetër dhe të miratohet raporti në janar.

Skender Hyseni – Shprehu mendimin se nuk do të duhej të lëshohemi në debatin për dallimin në mes të traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare, pasi që Konventa e Vjenës për Traktate e specifikon atë.

Albin Kurti – Shprehu mendimin se është mirë të punohet edhe pak në raport dhe në mbledhjen e ardhshme të përmbillet kjo çështje dhe të miratohet raporti me vërejtjen që të mos zgjerohet shumë edhe sa i përket provizioneve kushtetuese, sepse ka mundësi që edhe në mbledhjen e radhës të mos miratohet.

Hydajet Hyseni – Tha se është problematike nëse ligji zbatohet ose interpretohet në mënyrë të diskutueshme nga aspekti i Kushtetutës dhe kjo po ndodh në praktikë. Andaj edhe rekomandimi kryesor i grupi punues është që të ndryshohet ligji dhe kjo i përfshin edhe çështjet e tjera të diskutueshme. Më tej shtoi se institucionet nuk e kanë të njëjtin perceptim të dispozitës kushtetuese, ajo nuk interpretohet njëjtë dhe se ligji nuk mund ta ndryshoj Kushtetutën, por mund ta saktësoj dhe ta evitoj mundësinë e dykuptimësive.

Pas diskutimeve, kryetari konstatoi se Komisioni nxori këtë:

Përfundim

Raporti për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Marrëveshjet Ndërkombëtare, të shqyrtohet dhe të miratohet në mbledhjen e radhës së Komisionit.

Takimi përfundoi në orën 12:10

Kryetari i Komisionit

Albin Kurti

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit